

# Per Qytetaret Jokomunitare:

## DOKUMENTAT QE DUHET TE PARAQISNI PER PRAKTIKAT E MEPOSHTEME

### **REGJISTRIM ANAGRAFIK (kur vini nga vendi juaj ose nga një komunë tjetër italiane)**

Për çdo antar të familjes që transferohet duhet të paraqisni këto dokumenta:

- Pashaportën
- Lejën e qëndrimit të vlefshme (nëqoftëse ka skaduar duhet të paraqisni riçevutën e rinovimit)
- Kodin fiskal
- Kartën e identitetit të lëshuar nga një komunë tjetër italiane (nëse e keni)
- Patentën italiane (edhe kopjen) nëse e keni
- Targën e autpmjeteve që keni në pronësi personale ose me të tjerë. (nëse keni automjet)
- Certifikatën e martesës dhe të lindjes të përkthyer dhe legalizuar (nëse e keni)

### KINI KUJDES

### RASTE TE VECANTA

a) Për qytetarët në pritje të lejës së parë të qëndrimit, mbas praktikës së bashkimit familjar:

Duhet të paraqisni kopjen e nulla osta, të lëshuar nga Prefektura dhe riçevutat postale të kërkesës për lejën e parë të qëndrimit.

b) Për qytetarët në pritje të dhënies së lejes së parë të qëndrimit: Duhet të paraqisni kopjen e nulla osta, të lëshuar nga Prefektura, kontratën e qëndrimit, të firmosur pranë sportelit Unik për Emigracionin dhe ricevutat postale të kërkesës së lejes së parë të qëndrimit.

c) Për qytetarët që kërkojnë rinjohjen e qytetarisë italiane *jure sanguinis* (për ata që kanë origjinë direkte nga qytetarë italianë që nga lindja): brenda tre muajve nga hyrja në Itali mund të kërkohet regjistrimi anagrafik duke paraqitur kodin fiskal, pashaportën me vulën e hyrjes në Itali. Në rastet kur qytetari hyn në Itali nga një vënd tjetër, antar i Schengen-it, duhet të paraqesë dhe deklaratën e pranisë të bërë në Kuesturë brenda 8 ditëve të para të hyrjes në Itali.

d) Për qytetarët në pritje të lejës për *coesione familiare* me një qytetar/re italian/e ose komunitar: duhet të paraqitet dhe riçevuta e Kuesturës për motiv familjar. Menjëherë mbasi të merrni lejën e parë, duhet ta paraqiteni në zyrën anagrafe për të specifikuar regjistrimin.



## **NDRYSHIM ADRESE (ndryshim brenda Komunës së Astit)**

Ju duhet të paraqisni një dokument rinjohje (pashaportë, kartë identiteti ose patentë) të deklaruesit dhe për çdo antar të familjes që transferohet, këto dokumenta:

- Lejë qëndrimi të vlefshme (nëse ka skaduar, paraqisni riçevutën e rinovimit)
- Patentën italiane (edhe kopjen) nëse e keni
- Targën e mjeteve të transportit, pronë e juaja ose bashkëpronë me të tjerë, nëse keni.



## **RINOVIM I DEKLARIMIT TE BANESES KU JETONI (regjistrim i lejës ose kartës së qëndrimit)**

Rinovimi i deklarimit të adresës së banesës ku jetoni (regjistrim i lejës / kartës së qëndrimit dhe deklarata e adresës ku jetoni në këtë moment) është i detyrueshëm brenda 60 ditësh nga marrja e dokumentit të qëndrimit.

Ju duhet të paraqisni :

- Një dokument rinjohje (pashaportë, kartë identiteti, patentë ) të vlefshme
- Lejë/kartë qëndrimi për ta regjistruar

### **KINI KUJDES:**

Në rast qytetari të rritur, deklarata duhet të jetë e firmosur personalisht përpara punonjësit të sportelit. Në rast pamundësie për tu paraqitur në sportel, qytetari mund të paraqisë deklaraten e tij nëpërmjet një familiari ose ta dërgojë me fax, duke i bashkangjitur dokumentat e nevojshme.

Në rast qytetari të mitur të lindur në Asti, duhet të regjistrohet dhe leja e parë e lëshuar nga questura.



## **KARTA E IDENTITETIT (mund të lëshohet mbasi ka mbushur 15 vjet dhe NUK ESHTË E VLEFSHME PER UDHETIME JASHTË ITALIE)**

Për kartën e parë të identitetit në Itali duhet të paraqisni:

- Pashaportën
- Lejën e qëndrimit të vlefshme (ose të skaduar sëbashku me riçevutën e rinovimit)

### **KINI KUJDES**

Mund të kërkonte kartën e identitetit dhe kur jeni në pritje të lëshimit të lejes së parë për motive pune dhe motive familiare duke paraqitur pashaportën, riçevutën e postës dhe nulla osta të lëshuar nga Prefektura.

Rinovimi i kartës së identitetit – duhet të paraqisni:

- Kartën e identitetit të skaduar (në raste vjedhje ose humbje duhet të paraqisni denoncimin e faktit pranë një organi polizie) dhe një dokument tjetër rinjohje të vlefshëm – patentë, pashaportë, kartë qëndrimi. Në mungesë të këtyre dokumentave duhet të paraqiteni me dy dëshmitarë, të pajisur me dokumenta të vlefshme.
- Lejën e qëndrimit të vlefshme (nëse është e skaduar duhet të keni me vete riçevutën e rinovimit).